



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/131

Datë: 24.05.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi (4) dhe nenit 93 paragrafi (4) si dhe nenit 145(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe nenin 19 (6.2.) të Rregullores së Punës së Qeverisë të Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 24.05.2013, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet nënshkrimi i Planit të Zbatimit, të parafuar më 22 maj 2013, nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri i Republikës së Serbisë, për zbatimin e Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve, mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, parafuar më 19 maj 2013, nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri i Republikës së Serbisë.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës mbështet zotimet e përmbajtura në këtë Plan Zbatim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/131

Datë: 24.05.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2013, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Komiteti Drejtues Ndërinstitucional për mbikëqyrjen dhe koordinimin e zbatimit të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas, 2009 -2015 në këtë përbërje:

- | | |
|---|--------------------|
| 1.1. Vlora Çitaku, Ministre e Integritimeve Evropiane | Kryesuese; |
| 1.2. Dalibor Jevetic, Ministër për Kthim dhe Komunitete | zëvendës kryesues; |
| 1.3. Ramë Buja, Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë | anëtar; |
| 1.4. Dardan Gashi, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor | anëtar; |
| 1.5. Ferid Agani, Ministër i Shëndetësisë | anëtar; |
| 1.6. Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale | anëtar; |
| 1.7. Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë/ZKM | anëtar; |
| 1.8. Serdjan Popoviq, Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve/ZKM | anëtar; |

2. Ftohen që ta dërgojnë nga një përfaqësues:

- | | |
|---|---------|
| 2.1. Përfaqësues, Organizata joqeveritare Iniciativa 6 | anëtar; |
| 2.2. Përfaqësues, Organizata joqeveritare Fahri Vraniqi | anëtar; |
| 2.3. Përfaqësues, Qendra e Komitetit Ashkali | anëtar; |
| 2.4. Përfaqësues, Këshilli Konsultativ për Komunitete | anëtar; |
| 2.5. Përfaqësues, Avokati i Popullit | anëtar; |

3. Komiteti Drejtues Ndërinstitucional kryen detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas për vitin 2009-2015 të aprovuar nga Qeveria e Kosovës.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, Ministrat, institucionet tjera dhe anëtarët e Komitetit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit shërben si Sekretariat i Komitetit Drejtues Ndërinstitucional.
6. Shfuqizohet vendimi i Qeverisë nr. 12/52 i datës 14.12.2011
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë